# Pasojat

—Largimi nga shkolla.

—Probleme psikologjike dhe fizike.

—Mbyllje në vetvete, qëndrim në shtëpi, izolim, tentim vetëvrasje dhe vetëvrasje.



# Porosia nga të rinjtë e Kaçanikut

Liria e të shprehurit nuk është liri e bullizmit.

Të përulësh të tjerët nuk ju ndihmon juve që të ngriteni më lartë.

Ju nuk jeni vetëm, ne jemi këtu t'ju ndihmojmë kundër bullizmit.

Iniciativa "Stop Bullizmin" në Kaçanik mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

# STOP BULLIZMIT

Bullizmi është një dhunë psikologjike ose fizike e ushtruar vazhdimisht nga një individ ose grup individësh drejt një individi tjetër.

NDAL BULLIZMIN

# LLOJET E BULLIZMIT

## Bullizmi fizik

Formë e abuzimit fizik, grushtimi, shkelmimi dhe gjëra të tjera për t’i futur frikën dikujt.



## Bullizmi verbal

Fjalët dhe gjuha poshtëruese, për shembull ngacmimi, thashethemet, nofkat ofenduese dhe kërcënimet.



## Bullizmi seksual

Ngacmim që ndodh në lidhje me trupin, seksin, orientimin seksual ose me aktivitetin seksual të një personi.



## Bullizmi kibernetik

Mesazhe të çastit, mesazhe me tekst në telefon celular, në rrjete sociale dhe internet, për të fyer dhe për të vënë në siklet personin tjetër.



## Parandalimi

—Informimi i të rinjve rreth bullizmit.

—Aktivitete gjithëpërfshirëse rinore.

—Grupe përkrahëse në shkolla.

—Krijimi i një grupi avokues kundër bullizmit.

—Përkrahje nga bashkëmoshatarët, familja dhe psikologu i shkollës.

